



NA MJAFTON



FUQIA JONË

KOSOVA DJE, SOT DHE NESËR

MUHAMED (14), ARBA (14), ONIKSA (14), EDONIS (14), DIONIS (14), LEON (14), ALTIN (14), FLETA (14), RIGON (14)



Ne, fëmijët e Kosovës kemi imagjinuar veten si themelues dhe anëtarë të një partie politike. Çfarë do të arrinim ne si parti politike? Për këtë dhe më shumë do të lexoni në vazhdim të këtij artikulli

Përshëndetje të nderuar lexues. Për juve, kemi përgatitur artikullin dhe vizatimet në vijim. Shpresojmë që ato do t'iu pëlqejnë shumë. Ne jemi një grup i qytetarëve, të cilët përbëjmë partinë „Iniciativa Qytetare për Mjedis dhe Pastërti“. Si qëllim kryesor ne kemi pastërtinë në të gjithë Kosovën. Partia jonë ka ndërmend që pasi ta marrë pushtetin, ndërtime pa leje t'i rrëzoj dhe në ato hapësira të ndërtoj parqe të reja. Kjo në mënyrë që të kemi sa më shumë gjelbërim në vendin tonë. Ky edhe është problem aktual në vend dhe

është çështje mjaft shqetësuese për qytetarët, pasi që ajri i papastërt vie edhe nga probleme të tjera. Ngrohja me qymyr, fabrikat e ndryshme në qendrat urbane dhe mbeturinat e hedhura në vende jo të duhura, përbëjnë problemet kryesore, me të cilat qytetarët e Kosovës ballafaqohen për çdo ditë. Mirëpo, kjo nuk do të thotë që ne do t'i lëmë anash çështjet me rëndësi si: shëndetësia, arsimimi, zhvillimi ekonomik, punësimi i qytetarëve, etj. Këta qytetarë janë shumë me fat që zgjedhjet komunale janë afruar dhe kanë opsione të mira për të zgjedhur. Njëra ndër to është „Iniciativa Qytetare për Mjedis dhe Pastërti“. Ne, përveç planit, kemi udhëheqës dhe kandidatë të mirë. Qëllimi ynë është që këta kandidatë të fitojnë sa më shumë vota në sa më shumë komuna të Kosovës.



Puna jonë është e shenjtë dhe e paprekshme



Ne jemi gazetarët më të dalluar të Kosovës

Më poshtë do të mund të lexoni disa pjesë të raportimit të gazetarëve tanë gjatë ditës së zgjedhjeve komunale. Ju gjithashtu do të mund të mësoni për fatin e partisë „Iniciativa Qytetare për Mjedis dhe Pastërti“

„Sot po mbahen zgjedhjet lokale në tërë Kosovën. Jemi në qendër të Prishtinës, në vendvotimin në shkollën fillore „Faik Konica“. Gjendja në këtë qendër të votimit është në rregull dhe nuk ka asnjë parregullësi të shënuar deri më tani. Shpresojmë se kështu do të vazhdojë në Prishtinë dhe në të gjitha komunat e tjera. Deri në këto çaste, kolegët tanë na tregojnë se gjendja në komunat e tjera është gjithashtu në rregull. Në këto zgjedhje, ashtu siç e dini, do të përzgjedhet kryetari i ri i komunës dhe asamblistët komunal.“ Kështu u raportua gjatë kohës sa qytetarët votonin.


Reportazhi vijon: „Sapo u mbyllën të gjitha qendrat e vendvotimeve. Kurse, tani do të filloj procesi i numërimit të votave. Partitë politike kanë idetë e tyre politike dhe ato shpresojnë që partia e tyre të fitoj, pasi që mendojnë se kanë ide të përbashkëta me qytetarët. Partitë synojnë t'i realizojnë të gjitha premtimet e tyre

të bëra gjatë fushatës parazgjedhore, pasi të fitojnë votat e qytetarëve.“

Në fund, gazetarët raportojnë: „Pas përfundimit të numërimit të votave, rezultatet tregojnë që në komunat më të mëdha të Kosovës, partia „Iniciativa Qytetare për Mjedis dhe Pastërti“ ka fituar shumicën e votave. Pasi që intervistua udhëheqësit e kësaj partie, neve na premtuan që ata do t'i realizojnë premtimet e dhëna për një mjedis dhe një Kosovë sa më të pastër.“ Ky reportazh vije nga imagjinata e grupit tonë. Përmes tij kemi dashur të tregojmë për dëshirën tonë të madhe për ta parë Kosovën në gjendje më të mirë. Qytetarët e Kosovës kanë të drejtë të shprehin mendimet e tyre. Këtë e bëjnë përmes votave. Pikërisht për këtë arsye është caktuar mosha 18 vjeçare për të votuar. Mezi presim të arrijmë këtë moshë që edhe ne të votojmë dhe të shprehim mendimet tona.



Partia jonë ka nevojë për sa më shumë mbështetës



Kjo është arma jonë më e fortë



Vota është e fshehtë, anonime dhe e barabartë



Ndarja e Pushtetit, do të jetë artikulli në vazhdim

TRI SHTYLLAT E SHTETIT



ELMEDINA (14), RINESA (14), RINOR (15), OLTİ (14), MUHAMED (15), KALTRINA (14), JON (14),
GENT (15), BLERT (14)

Pushteti është autoriteti i një personi ose institucioni për të kontrolluar diçka. Në vendet demokratike, pushteti ndahet në tri degë: dega Legjislative, Ekzekutive dhe Gjyqësore

Çdo shtet i botës ka mënyrën e tij të qeverisjes. Këto mënyra dallojnë nga njëra-tjetra. Ndarja e pushtetit është tregues i nivelit të demokracisë së një vendi. Ne mendojmë se në krahasim me pushtetin absolut, ndarja e pushtetit është e dobishme për një vend, sepse pushteti nuk mund t'i përkasë vetëm një personi ose institucioni. Në këtë mënyrë, çdo degë e pushtetit luan rol të caktuar, sipas të cilit ai funksionon. Në vendin tonë, secili pushtet punon në mënyrë të pavarur nga pushtetet e tjera. Nuk ndodh asnjëherë që një pushtet të ndërhyjë në detyrat e pushteteve të tjera. Më shumë për këto degë lexoni më poshtë.



Gazetarët e artikullit që po e lexoni



Këtu kemi paraqitur tri institucionet që janë përgjegjëse për të tri degët e pushtetit. Kuvendi, Qeveria dhe Gjykata

PUSHTETI LEGJISLATIV

Ka për detyrë të propozojë ligje dhe t'i miratojë ato. Pushtetin Legjislativ e ushtron Kuvendi. Në Kuvend bëjnë pjesë deputetët, të cilët janë gjithsej 120. Ata me anë të miratimit të ligjeve, kujdesen që qytetarët e Kosovës të kenë jetë dhe të ardhme sa më të mirë. Të gjitha ligjet të cilat miratohen në Kuvend, duhet të zbatohen nga të gjithë qytetarët. Kuvendi është i vetmi institucion ligjvënës në Kosovë.

PUSHTETI EKZEKUTIV


Ligjet të cilat miratohen në Kuvend duhen të zbatohen. Për këtë kujdeset Pushteti Ekzekutiv - Qeveria. Ky institucion është shumë i rëndësishëm, sepse po të mos ishte Qeveria as ne nuk do të dinim se si do të zbatoheshin ligjet. Qeveria përbëhet nga: Kryeministri, ministrat dhe zëvendësit e tyre. Detyrë e këtij institucioni është që ligjet që mirren nga Kuvendi të mos mbeten të pazbatuara.

PUSHTETI GJYQËSOR

Degë tjetër e pushtetit është Pushteti Gjyqësor që ushtrohet nga Gjykata. Detyra e saj është që të merret me qytetarë, të cilët veprojnë në kundërshtim me ligjin. Rastet më të shpeshta që sillen në Gjykatë janë: tejkalimi i shpejtësisë, ku personi i cili ka kaluar shpejtësinë dhe ka thyer rregullat e komunikacionit fillimisht gjobitet, më pas çështja silllet në gjykatë dhe merret vendimi për të akuzuarin.

I NDIHMOJMË TË TJERËT ME SHUMË VULLNET

BLEND (14), BLENDI (14), ARLIND (15), AMAR (14), ANJEZA (15), DRILON (15), MJELLMA (15), ROZAFI (14), ERJON (14)



Jam e lumtur që mund të jem qytetare shumë aktive

nga vullneti ynë i madh dhe nga dashuria që e kemi për vendin tonë. Ndër të tjerash, s'duhet të harrojmë të përmendim edhe pjesëmarrjen në zgjedhje. Hap ky, i cili përcakton të ardhmen e vendit e që njëkohësisht është pjesë e qytetarisë aktive. Një votë e një qytetari aktiv, ndikon që të ndryshohet e tërë qeverisja e vendit. Andaj, bëhu ti ai/ajo që përcakton shumëçka. Ti mundesh, sepse ti ke mundësi të jesh ai/ajo që vendos.




Lulet e demokracisë

A e dini cilat janë përgjegjësitë tona si qytetarë aktiv të një shteti demokratik? Këto dhe shumë të tjera do t'i mësoni në artikullin tonë, të shkruar me shumë dashuri për ju

Qytetarët e shteteve demokratike kanë më shumë mundësi dhe liri që të kontribuojnë për zhvillimin e shtetit të tyre. E tërë kjo vë nga mundësia që ata kanë për të shprehur mendimet lirshëm, për të lëvizur lirshëm, si dhe nga mundësia për të zgjedhur lirshëm. Vullneti për të kontribuar për komunitetin tuaj njihet si qytetari aktive. Qytetaria aktive karakterizohet me: përfshirjen në punë vullnetare, marrjen e iniciativave pozitive për vendin, pjesëmarrjen në organizata jo qeveritare, votimin në zgjedhje shtetërore, si dhe me shumë aktivitete të tjera. Synimi i qytetarisë aktive është t'iu ndihmojnë të tjerëve në mënyrë që të arrihet mirëqenia sociale për të gjithë. Edhe ne, autorët e këtij artikulli, jemi treguar shumë herë qytetarë të përgjegjshëm dhe shumë aktiv. Këtë e kemi bërë duke propozuar ide të ndryshme dhe duke bashkëpunuar me të tjerët, me qëllim që t'i realizojmë ato. Një prej iniciativave që i kemi ndërmarrë ne është: mbjellja e luleve për ta ruajtur ambientin dhe për ta gjelbëruar atë. Gjithashtu, ne kemi marrë iniciativë që ta pastrojmë sheshin e kryeqytetit.

Po ashtu, kemi përgatitur ushqime dhe i kemi shitur ato, kurse me paratë që i kemi mbledhur i kemi ndihmuar njerëzit me nevojë. Ndërsa, për shkollën tonë jemi mbledhur dhe me punë vullnetare kemi pastruar oborrin e shkollës. Krejt këto iniciativa kanë buruar



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Faik Konica“
Klasa: IX-2 & IX-4
Vendi: Prishtinë